APPROVAL OF STATUTE OF POLIS UNIVERSITY

Based of Article 102 of the Constitution, Article 33 of Law No. 80/2015 "*For the higher education of the Republic of Albania*",

ORDER:

1. The approval of the statute of the polis university, proposed by Senate Decision no. 13, 13.06.2016, (with 35 pages).

2. All regulations and other acts of the Polis University to be approved in accordance with this statute and the legal framework in force.

3. Within the a.y. 2017-2018, the University of Polis must transmit to the Ministry of Education all the deeds and documentation of the government bodies and authorities, of the staff referred to in this provision.

4. Changes in the Polis Statute are approved in accordance with the current legal framework and statute.

5. The Statute of the Polis Private High School is abolished.

6. This order takes effect immediately.

Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5 Kashar, Tiranë, Shqipëri, Tel: +355 (4) 2407420 / 2407421, Fax: +355 (4) 2407422, Cel: +355 (0) 694088111
www.universitetipolis.edu.al; info@universitetipolis.edu.al
NUIS K62308008S

U-POLIS
NR. 406/17. PROT.
DT. 23.05.2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr 5299 Prot.

Tiranë, më 19.05.2017

URDHËR

Nr 281, datë 19.05.2017

PËR

MIRATIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT "POLIS"

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Universitetit "Polis", propozuar me Vendimin e Senatit Akademik nr.13, datë 13.06.2016, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri (35 faqe).

2. Të gjitha rregulloret dhe aktet e tjera të Universitetit "Polis", të miratohen në zbatim të Statutit të Universitetit "Polis" dhe kuadrit ligjor në fuqi.

3. Universiteti "Polis" brenda vitit akademik 2017-2018 të paraqesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të gjitha aktet dhe dokumentacionin ligjor për organet dhe autoritetet drejtuese, personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, sipas përcaktimeve të këtij statuti.

4. Ndryshimet në statutin e Universitetit "Polis", miratohen sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe këtij statuti.

5. Statuti i Shkollës së Lartë Private "Universitetit Polis", shfuqizohet.

6. Statuti i Universitetit "Polis", hyn në fuqi pas hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Universiteti "Polis".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TIRANË

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Web site: www.arsimi.gov.al

UNIVERSITETI POLIS

STATUTI

I

UNIVERSITETIT POLIS

UNIVERSITETI POLIS

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Universiteti POLIS

1. Universiteti POLIS është institucion jo publik i arsimit të lartë. Ai është person juridik privat fitimprurës. Universiteti POLIS ka karakter akademik, kërkimor-shkencor dhe aplikativ me programe në katër nivele të mësimdhënies, nivelet 5 – 8 të kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.
2. "Universiteti POLIS" është person juridik, krijuar me vendim gjykate Nr. 35386, datë 04.04.2006 dhe licensuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 698, datë 11.10.2006. Universiteti POLIS ka kryer akreditim të parë institucional me Urdhrin Nr.227, datë 22.07.2009 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe ka fituar statusin "UNIVERSITET" me Vendim Nr.746, datë 24.10.2012 të Këshillit të Ministrave.
3. Universiteti POLIS ka autonomi organizative dhe vetëqeverisje si institucion jopublik i arsimit të lartë dhe vepron në përputhje me parimet dhe normat e parashikuara në: Kushtetutën e Shqipërisë; Kodin e Punës; Ligjin e Arsimit të Lartë Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" *(i ndryshuar)*; Ligjin Nr.9723, Nr.03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" *(i ndryshuar)*; *Dokumentin e Reformës për Arsimin e Lartë*, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi
4. Universiteti POLIS ofron programe të akredituara studimi me kohë të plotë dhe kohë të zgjatur.
5. Universiteti POLIS shpall publikisht titujt e diplomave dhe programet e studimit para aplikimit të kandidatëve për pranim në të.
6. Për kryerjen e veprimtarive të arsimimit dhe kërkimit me interes të përbashkët, Universiteti POLIS bashkëpunon me institucione të tjera: universitete, institucione kërkimore, kulturore, ekonomike, publike dhe private, OJF, etj..
7. Universiteti POLIS ka faqen e tij zyrtare të internetit www.universitetipolis.edu.al

Neni 2
Vizioni

1. Vizioni i Universitetit POLIS është të ofrojë ekselencë në edukimin e profesionistëve dhe kërkuesve shkencorë të aftë për të adresuar nevojat e tregut dhe shoqërisë në fushat e interesit në vend dhe jashtë tij. Për këtë Universiteti POLIS ka këto synime kryesore:
   a. të pajisë studentët me cilësitë e lidership-it profesional në fushat që mbulon në mënyrë që të ushtrojnë influencë për zhvillim pozitiv të vendit dhe rajonit;
   b. të pajisë studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike sipas standardeve më të larta bashkëkohore duke synuar integrimin e tyre në tregun e punës vendas dhe ndërkombëtar;
   c. të kryejë aktivitete studimore, kërkimore, shkencore dhe praktike të lidhura ngushtë me veprimtarinë akademike dhe programet e studimeve që zhvillon;
   d. t'i shërbejë inovacionit ne fushat ku shtrin veprimtarinë e tij si dhe të ndikojë, në këto fusha, zhvillimet në rajon.
   e. Universiteti POLIS synon të kthehet në një platformë rajonale dhe pikë reference në Ballkan dhe rajonin e Adriatikut dhe Jonit.

UNIVERSITETI POLIS

Neni 3
Misioni

1. Misioni i Universitetit POLIS është përcaktuar më aktin e tij të themelimit sipas vendimit të gjykatës cituar në nenin 1, pika 2 dhe është i fokusuar në veprimtari të edukimit, kërkimit shkencor e të aplikuar dhe të inovacionit në fushat e tij të interesit.
2. Universiteti POLIS ka në themel të misionit të tij këto objektiva:
   a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe të aplikuar si dhe inovacionit;
   b) të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në fushën e dizajnit, arkitekturës dhe inxhinierisë, shkencave të territorit, menaxhimit dhe politikave të zhvillimit;
   c) të ofrojë studime në nivelin e Diplomës Profesionale, Bachelor-it, Masterit dhe Doktoratës për fushat e përcaktuara më sipër;
   ç) të ofrojë mundësinë e formimit profesional dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës;
   d) të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor;
   dh) të kontribuojë nëpërmjet edukimit, kërkimit shkencor dhe të aplikuar, dhe inovacionit në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit;
   e) të kontribuojë për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë dhe shkrencës në vend nëpërmjet bashkëpunimit rajonal, europian dhe ndërkombëtar.

Neni 4
Autonomia akademike, financiare dhe organizative e Universitetit POLIS

1. Ligji Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", e njeh Universitetin POLIS si institucion autonom dhe i jep liri akademike, financiare dhe organizative.
2. Liria akademike në mësimdhënien universitare nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së opinioneve, ideve e metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Kjo liri akademike ushtrohet në përputhje me planet dhe programet mësimore e kërkimore, të hartuara dhe miratuara nga instancat përkatëse, të parashikuara në këtë statut dhe në rregulloret e universitetit.
3. Liria akademike në Universitetin POLIS garantohet nëpërmjet së drejtës:
   a) për të organizuar veprimtaritë e mësim-dhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese;
   b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
   c) për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.
4. Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës:
   a) për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet dhe praktikat profesionale, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi;
   b) për të përfituar fonde nga shteti dhe organizma të tjerë;
   c) për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit;
   ç) për të përcaktuar tarifat e studimit dhe të shërbimeve që ofron sipas statutit dhe rregulloreve të Universitetit POLIS, hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
   d) për të administruar burimet dhe pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që institucioni zotëron ligjërisht, në përputhje me misionin e tij dhe aktin e themelimit.

5. Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet të drejtës:
   a) për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur/emëruar organizmat dhe autoritetet drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të brendshme të Universitetit POLIS, të hartuara në përputhje me me legjislacionin në fuqi dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi;
   b) organizimin dhe zhvillimin e pavarur të programeve të studimit dhe projekteve të kërkimit
   c) për të caktuar kriteret dhe kuotat për pranimin e studentëve në programet e studimit sipas statutit dhe rregulloreve të Universitetit POLIS, hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
   ç) për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive të mësimdhënies, kërkimit shkencor, të aplikuar dhe inovacionit, kualifikimit profesional, shërbimet ndaj palëve të treta, si edhe veprimtari të tjera të ligjshme;
   d) për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij sipas nevojave të veprimtarisë së Universitetit POLIS bazuar në statutin dhe rregulloret e Universitetit POLIS, hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Shteti garanton paprekshmërinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe të territorit të tyre përfshirë këtu edhe Universitetin POLIS. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike bëhet me kërkesën ose lejen e Rektorit të Universitetit POLIS. Vetëm në rastet e rregulluara me ligj, autoritetet publike kanë të drejtë të ndërhyjnë edhe pa lejen e Rektorit të Universitetit POLIS. Cenimi i paprekshmërisë së institucioneve të arsimit të lartë nga subjekte të tjera publike e private ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
7. Ky statut është hartuar në përputhje me ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Dokumentin e Reformës së Arsimit të Lartë. Statuti respekton specifikat e IAL jopublike fitimprurëse që rregullohen nga Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" *(i ndryshuar)*. Ai aplikohet në të gjitha aktivitetet dhe njësitë organizative të Universitetit POLIS.

KREU II
STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Neni 5
Struktura Organizative

1. Universiteti POLIS është institucion i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale, i organizuar në nivele të ndryshme dhe ka autoritetet e veta brenda këtyre niveleve. Universiteti POLIS përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit. Ai ka në përbërje tre njësi kryesore.
2. Në strukturën organizative të Universitetit POLIS dallohen 4 (katër) lloje njësish përbërëse organizative:
   a. Njësi kryesore është Fakulteti dhe/ose Instituti (kur ky i fundit plotëson të njëjtat standarde si Fakulteti);

b. Njësi bazë është departamenti dhe qendra kërkimore;

c. Njësi ndihmëse janë laboratorë, atelie, studio profesionale etj.;
ç. Qendër Studimore Ndërdisiplinore Kërkimore dhe Inovacioni – Universiteti POLIS ka një qendër studimore ndërdisiplinore synimi kryesor i së cilës është promovimi i të gjitha praktikave, metodologjive dhe qasjeve kërkimore dhe inovative që sjellin risi në fusha të ndryshme të shkencës dhe teknologjisë. Ajo vepron si një njësi ndërdisiplinore që kombinon aktivitetet e njësive kryesore me qëllim sjelljen dhe nxitjen e zgjidhjeve të reja krijuese dhe eksperimentale.

3. Struktura organizative e Universitetit POLIS është objekt ndryshimi në funksion të llojeve dhe programeve të studimit që ofron bazuar në statutin dhe rregulloret e Universitetit POLIS, hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Hapja e njësive kryesore, riorganizimi ose mbyllja e tyre bëhen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, në bazë të propozimit të Universitetit POLIS, pas miratimit të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.
5. Hapja, riorganizimi ose mbyllja e njësive bazë bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përfundim të vitit akademik, pas miratimit të Bordit të Administrimit të Universitetit POLIS. Ky vendim i njoftohet brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor, ministrisë përgjegjëse për arsimin.
6. Struktura organizative e Universitetit POLIS dhe emërtimet e të gjitha njësive përbërëse gjendet në Shtojcën 1 të këtij Statuti, që është pjesë integrale dhe e pandarë e tij.

Neni 6
Fakulteti

1. Fakulteti është njësi kryesore e Universitetit POLIS që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore të përafërta ose të ndërthurura.
2. Fakulteti ofron programe studimi të niveleve të ndryshme në përfundim të të cilave përfitohet diplomë e specifikuar sipas programit të kryer nga studenti.
3. Fakulteti organizohet në njësi bazë dhe ka në përbërjen e tij dy departamente dhe një qendër kërkimore.
4. Struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij, miratohet nga Senati Akademik, sipas përcaktimeve të statutit, akteve të tjera të Universitetit POLIS dhe legjislacionit në fuqi.
5. Fakulteti miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, bazuar në propozimet e njësive bazë, në përputhje me përcaktimet e statutit, akteve të tjera të Universitetit POLIS dhe legjislacionit në fuqi.
6. Fakulteti drejtohet nga Dekani, i cili emërohet nga Rektori.

Neni 7
Instituti për Kërkim dhe Zhvillim

1. Instituti për Kërkim dhe Zhvillim është njësi kryesore e Universitetit POLIS në përmbushje të të gjithë kritereve dhe standardeve të parashikuara për këto njësi. Instituti kryen aktivitet hulumtues dhe didaktik.
2. Instituti drejtohet nga Drejtuesi i cili është staf akademik me kohë të plotë dhe mban të paktën gradën shkencore "Doktor". Drejtuesi i Institutit emërohet nga Rektori.
3. Instituti për Kërkim dhe Zhvillim ka në objekt të punës së tij:
   a. të përpilojë planin vjetor të U_POLIS për punë kërkimore-shkencore;
   b. të organizojë programin e studimit të ciklit të tretë
   c. të kryejë veprimtari kërkimore shkencore dhe zhvillimi;

d. të realizojë studime të aplikuara, hulumtim dhe raporte shkencore brenda fushës së mbulimit;

e. të asistojë në realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë.

Neni 8
Departamenti

1. Departamenti i Universitetit POLIS është njësia bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive.
2. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore.
3. Departamenti është përgjegjës për programet e studimit që ofron Universitetit POLIS.
4. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë.
5. Departamenti propozon kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore. Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e Universitetit POLIS.
6. Departamenti pranë çdo njësie kryesore (Fakultet / Institut) ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës akademik.
7. Departamenti mund të ofrojë shërbime për të tretë, si dhe të zhvillojë veprimtari të tjera, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të përcaktuara në statutin dhe aktet e tjera të Universitetit POLIS.
8. Rregulla të tjera për funksionimin e departamentit përcaktohen sipas rregulloreve të Universitetit POLIS.
9. Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi i tij, i cili propozohet nga Drejtuesi i Njësisë Kryesore dhe emërohet nga Rektori.

Neni 9
Qendra kërkimore-shkencore

1. Qendra kërkimore-shkencore e njësisë kryesore është njësi bazë që kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi.
2. Qendra mund të mbështetë realizimin e programeve të studimeve të ofruara nga departamentet e fakultetit përkatës ose departamente të fakulteteve të tjera.
3. Struktura e qendrës, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i saj përcaktohen sipas rregulloreve të Universitetit POLIS.

Neni 10
Qendra studimore ndërdisiplinore

1. Për interesa të përbashkët studimorë, kërkimorë dhe zhvillimorë, njësitë kryesore përbërëse të Universitetit POLIS kanë krijuar dhe mund të krijojnë qendra studimore ndërdisiplinore.
2. Struktura e qendrës studimore ndërdisiplinore, përbërja, funksionimi, drejtimi i saj përcaktohen në statutin dhe në aktet e tjera të Universitetit POLIS.

UNIVERSITETI POLIS

KREU III
ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I UNIVERSITETIT POLIS

Neni 11
Organet dhe autoritetet drejtuese

1. Organi më i lartë drejtues akademik është Senati Akademik. Organe të tjera akademike janë Asambleja e Personelit Akademik dhe Komisionet e Përhershme.
2. Autoritetet drejtuese akademike janë rektori, drejtuesi i njësisë kryesore (Dekani/Drejtuesi i Institutit), drejtuesi i njësisë bazë (Përgjegjësi i Departamentit / Qendrës).
3. Organi më i lartë drejtues administrativ është "Asambleja e Ortakëve" dhe "Bordi i Administrimit".
4. Autoritetet drejtuese administrative janë: Administratori i shoqërisë (sh.p.k.), Administratori i IAL –së dhe Administratorët e Njësive Kryesore.
5. Organe të tjera kolegjiale janë: Rektorati, Dekanati, Këshilli i Etikës, Këshilli i Profesorëve si dhe organe të tjera të pavarurua:, Këshilli i Studentëve dhe Shoqata Alumi.
6. Universiteti POLIS ka të drejtë të krijojë në strukturën e tij autoritete dhe organe të tjera, në përputhje me misionin dhe veprimtaritë e institucionit, sipas përcaktimeve në këtë statut.

ORGANIZIMI AKADEMIK

Neni 12
Organet dhe Autoritet Drejtuese Akademike

1. Organet dhe Autoritetet drejtuese akademike në Universitetin POLIS janë:
   a. Senati Akademik;
   b. Rektori;
   c. Rektorati;
   d. Dekani / Drejtuesi i Institutit;
   e. Dekanati;
   f. Përgjegjësit e Njësive Bazë.
   g. Departamenti / Qendra;
2. Kriteret për autoritetet drejtuese, detyrat dhe të drejtat e këtyre autoriteteve, që burojnë nga ligji, përcaktohen në këtë statut dhe rregulloret e Universitetit POLIS

Neni 13
Senati Akademik

1. Senati Akademik i Universitetit POLIS është organi kolegjial më i lartë akademik, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij.
2. Senati Akademik i Universitetit POLIS kryesohet nga Rektori dhe mblidhet periodikisht.
3. Anëtarët e Senatit Akademik zgjidhen nga Asambleja e Personelit Akademik përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë

rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar.

4. Anëtarët e Senatit Akademik i Universitetit POLIS në institucionet e arsimit të lartë i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit,

kategoria e tyre mund të zbresë në nivel Master i Shkencave. Në Senatin Akademik përfaqësohen edhe studentët në masën 15 % (pësëmbëdhjetë për qind).

5. Senati Akademik i Universitetit POLIS përbëhet nga 19 (nëntëmbëdhjetë) anëtarë. Raportet e përfaqësimit janë: Rektori në cilësinë e Kryetarit, 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë të asamblesë së personelit akademik, dhe 3 (tre) përfaqësues të studentëve (një student për çdo njësi kryesore).
6. Në mbledhjen e parë të Senatit të zgjedhur, anëtarët konstituojnë përbërjen e tij dhe konfirmojnë Rektorin si Kryetar të Senatit Akademik.

Neni 14
Funksionet e Senatit Akademik

1. Senati Akademik mblidhet në seanca të zakonshme, së paku 1 (një) herë në 6 (gjashtë) muaj dhe më shpesh kur e thërret Rektori.
2. Mbledhjet e Senatit Akademik quhen të rregullta kur në to janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.
3. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë (mbi 50%) të anëtarëve pjesëmarrës. Për marrjen e vendimeve, mirëkuptimi dhe votimi i hapur është procedurë e zakonshme. Mënyra e votimit të fshehtë është e detyrueshme kur kërkohet nga shumica e të pranishmëve.
4. Vendimet e Senatit Akademik janë të detyrueshme për t'u zbatuar në të gjitha nivelet organizative të Univeristetit POLIS.
5. Në mbledhjet e hapura të Senatit Akademik mund të marrin pjesë të gjithë antarët e Asamblesë së Personelit Akademik të Universitetit POLIS, pa të drejtë vote.
6. Funksionet e Senatit Akademik janë:
   a) garanton autonominë e institucionit, lirinë akademike të stafit akademik, si dhe të drejtat e studentëve;
   b) konfirmon Rektorin e Universitetit si Kryetar të Senatit Akademik;
   c) miraton projekt-statutin me shumicë votash, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit, si dhe ndryshimet e mundshme të tij dhe ia dërgon për aprovim Asamblesë së Ortakëve;
   ç) i propozon planin strategjik të zhvillimit dhe programin vjetor të veprimtarisë së tij Bordit të Administrimit dhe Asamblesë së Ortakëve;
   d) harton strukturën e përgjithshme dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;
   dh) miraton rregulloret dhe aktet e tjera, sipas përcaktimeve të bëra në këtë statut;
   e) miraton hapjen, rioganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë në përputhje me buxhetin afatmesëm të institucionit, Në këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;
   f) miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
   g) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
   gj) krijon Komisionin Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, e për dhënien e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", si edhe komisionet e tjera të përcaktuara në statutin e institucionit;

h) vlerëson dhe garanton aktivitetet për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Universitin POLIS në përputhje me standardet europiane e kombëtare të cilësisë dhe garanton implementimin e tyre;
i) krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
j) organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

7. Funksione të tjera të Senatit Akademik përcaktohen në rregullohen e Senatit Akademik.

Neni 15
Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i Universitetit POLIS, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Rektori emërohet në detyrë nga Asambleja e Ortakëve dhe konfirmohet nga Senati Akademik çdo 4 (katër) vjet dhe drejton Rektoratin.
3. Rektori në Universitetin POLIS mban titullin "Profesor" dhe mund të vijë nga rradhët e personelit akademik me kohë të plotë të Universitetit POLIS.
4. Rektori drejton Senatin Akademik dhe raporton para tij.
5. Rektori nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik të Universitetit POLIS.
6. Rektori i paraqet Senatit Akademik planin strategjik të zhvillimit të institucionit.
7. Rektori, përveç përgjegjësive që mban si drejtues i Rektoratit, ushtron edhe këto funksione:
   a. ratifikon marrëveshjet e nënshkruara në emër të Universitetit POLIS për anëtarësimin e institucionit në organizata kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë, për bashkëpunim me universitete e shkolla të tjera të larta të vendit e të huaja, marrëveshje bashkëpunimi me organizma (jo)qeveritare, donatorë vendas e të huaj sipërmarrje private që mund të ndihmojnë në zhvillimin e Universitetit;
   b. miraton normat vjetore të ngarkesës mësimore shkencore për personelin mësimor shkencor.
   c. i propozon Bordit të Administrimit kuotat e pranimit të studentëve në Universitetin POLIS mbi bazën e rekomandimeve të njësive kryesore.
   d. emëron dhe shkarkon drejtuesit e njësive kryesore.
   e. emëron dhe shkarkon përgjegjësit e njësive bazë mbi bazë të propozimeve të drejtuesit të njësisë kryesore dhe dosjeve personale të kandidatëve.
   f. kryeson komisionin e përzgjedhjes së stafit akademik mbështetur në kriteret e miratuara dhe dosjet personale të kandidatëve.
   g. është përgjegjës dhe organizon punën për sigurimin e brendshëm të cilësisë në universitet.
   h. nënshkruan diplomat dhe suplementin e diplomave për çdo program studimi në të gjitha ciklet e studimit, pa të drejtë delegimi firme.
   i. ngre komisione e grupe pune për çështje, studime e veprimtari të veçanta.
   j. jep leje për hyrjen e forcave të rendit në mjediset e fakultetit dhe mund t'i thërrasë ato në rast nevoje.
   k. emëron dhe shkarkon Zëvendës - Rektorin.

Neni 16
Zëvendës-Rektori

1. Zëvendës-Rektori mban gradën shkencor "Doktor".
2. Emërohet në detyrë çdo katër vjet nga Rektori.
3. Zëvendës-Rektori ushtron kompetenca të përcaktuara në aktin e emërimit.
4. Zëvendës-Rektori i zëvendëson Rektorin, në rastet kur ky mungon, ose në raste të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Rektori mund të përcaktojë grupin e detyrave që mund të ushtrojë Zëvendës-Rektori me delegim, sipas pikës 3 të këtij neni.

6. Dispozita të tjera lidhur me Zëvendës-Rektorin përcaktohen në rregulloret e Universitetit POLIS.

Neni 17
Rektorati

1. Rektorati është organ kolegjial ekzekutiv i Universitetit POLIS i cili përbëhet nga:
   a. Rektori;
   b. Zëvendës-Rektori;
   c. Drejtuesit e njësive kryesore;
   d. Administratori i Shpk –së;
   e. Administratori i IAL-së;
2. Në mbledhjet e Rektoratit mund të marrin pjesë, për çështje të veçanta, edhe pa të drejtë vote dhe antarë të personelit akademik dhe administrativ.
3. Rektorati kryhesohet nga Rektori dhe ushtron këto funksione kryesore:
   a. harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe kryesore të Universitetit POLIS.
   b. zbaton të gjitha vendimet e Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit.
   c. harton planin vjetor të punës, në nivel institucional, në përputhje me planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit nga Senati Akademik.
   d. në bashkëpunim me Bordin e Administrimit harton dhe propozon projektbuxhetin për miratim në Asamblenë e Ortakëve.
   e. shqyrton rezultatet e raporteve të vlerësimit vjetor të cilësisë.
   f. monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të Universitetit POLIS.
   g. harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore dhe ia paraqet Senatit Akademik për miratim
4. Rektorati raporton në fund të vitit akademik në Senatin Akademik dhe në Bordin e Administrimit.

Neni 18
Asambleja e Personelit Akademik

1. Asambleja e Personelit Akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore.
2. Asambleja e Personelit Akademik zgjedh anëtarët e Senatit Akademik.
3. Asambleja e Personelit Akademik i sugjeron Rektorit, me kërkesën e tij, kandidaturat për emërimin e Drejtuesve të Njësive Kryesore të Universitetit POLIS.
4. Asambleja e Personelit Akademik merr pjesë në mbledhjet e hapura të Senatit Akademik të Universitetit POLIS, pa të drejtë vote.

Neni 19
Drejtuesi i Njësisë Kryesore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore është dekani i fakultetit/drejtuesi i institutit, i cili emërohet në detyrë nga Rektori çdo 4 (katër) vjet. Drejtuesi i njësisë kryesore duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë i Universitetit POLIS dhe të ketë të paktën gradën shkencore "Doktor".
2. Drejtuesi i njësisë kryesore është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.
3. Drejtuesi i njësisë kryesore i përcjell Senatit Akademik dhe Rektoratit propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij.
4. Drejtuesi i njësisë kryesore, përveç përgjegjësive që mban si drejtues, ushtron edhe këto funksione:
   a. organizon, drejton dhe kontrollon të gjithë punën mësimore e shkencore dhe administrative në fakultet.
   b. miraton planet dhe programet mësimore brenda njësisë kryesore që drejton dhe ndjek zbatimin e tyre.
   c. i propozon Rektorit normat vjetore të ngarkesës mësimore shkencore për personelin mësimor shkencor.
   d. organizon punën për hartimin, monitorimin, dhe rishikimin periodik të programeve të studimit të njësisë kryesore.
   e. firmos diplomën dhe suplementin e diplomës pas përfundimit të studimeve në të gjitha programet e studimit ofruar nga njësia kryesore e drejtuar prej tij, pa patur të drejtën e delegimit të firmës, personave të tjerë.

Neni 20
Zëvendës-dekani/Zëvendës-drejtuesi i Institutit

1. Zëvendës-dekani/Zëvendës-drejtuesi i Institutit emërohet dhe shkarkohet nga Dekani/Drejtuesi i Institutit.
2. Zëvendës-dekani/Zëvendës-drejtuesi i Institutit duhet të ketë kryer të paktën studimet në nivelin "Master".
3. Zëvendës-dekani/Zëvendës-drejtuesi i Institutit ushtron kompetenca të përcaktuara në aktin e emërimit.
4. Zëvendësdekani/Zëvendës-drejtuesi i Institutit zëvendëson Dekanin/Drejtuesin e Institutit, në rastet kur ky mungon, ose në raste të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Dekani/Drejtuesi i Institutit mund të përcaktojë grupin e detyrave që mund të ushtrojë Zëvendësi me delegim, sipas pikës 3 të këtij neni.
6. Dispozita të tjera lidhur me Zëvendës-dekanin/Zëvendës-drejtuesin e Institutit përcaktohen në rregulloret e Universitetit POLIS.

Neni 21
Dekanati / Këshilli i Institutit

1. Dekanati/Këshilli i Institutit në Universitetin POLIS është organ kolegjial që drejtohet nga Dekani/Drejtuesi i Institutit dhe përbëhet nga:
   a) Dekani/Drejtuesi i Institutit;
   b) Zëvendës-dekani/Zëvendës-drejtuesi i Institutit
   c) Administratori i njësisë kryesore;
   ç) Drejtuesit e Njësive Bazë;
2. Dekanati/Këshilli i Institutit harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij.
3. Dekanati/Këshilli i Institutit koordinon veprimtarinë e njësive bazë.

4. Funksionet e tjera Dekanatit/Këshillit Institutitit përcaktohen në rregulloret e Universitetit POLIS.

Neni 22
Përgjegjësi i Njësisë Bazë

1. Drejtuesi i Njësisë Bazë është Përgjegjësi, i cili emërohet në detyrë nga Rektori me propozim të Drejtuesit të Njësisë Kryesore, çdo 4 (katër) vjet.
2. Përgjegjësi i Njësisë Bazë është staf akademik me kohë të plotë dhe i përket kategorisë "Lektor".
3. Përgjegjësi, përveç përgjegjësive që mban si drejtues i njësisë bazë, ushtron edhe këto funksione:
   a. drejton punën për hartimin e planeve mësimore dhe programeve të lëndëve që mbulon njësia bazë dhe ndjek zbatimin e tyre;
   b. ndjek dhe koordinon aktivitetin shkencor në njësinë bazë në përputhje me planin vjetor;
   c. i propozon Drejtuesit të Njësisë Kryesore masat për shkeljen e disiplinës në punë për pedagogët;
   d. organizon analiza të herë-pas-herëshme të punës në njësinë bazë, mbështetur në mendimin e anëtarëve të njësisë bazë.

Neni 23
Njësia Bazë

1. Njësia Bazë në Universitetin POLIS është organ që drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit/Qendrës dhe përbëhet nga:
   a) Përgjegjësi i Departamentit/Qendrës;
   b) Personeli akademik me kohë të plotë
   c) Personeli akademik me kohë të pjesshme
2. Njësia Bazë harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë bazë, mbështetur në propozimet e personelit akademik të tij.
3. Njësia Bazë koordinon veprimtarinë akademike, praktike, shkencore dhe administrative të e njësisë.
4. Funksionet e tjera Njësisë Bazë përcaktohen në rregulloret e Universitetit POLIS.

Neni 24
Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës pranë Universitetit POLIS është një organ kolegjial këshillimor i cili diskuton probleme të etikës së jetës universitare. Ai i bën propozime Rektorit për këto çështje.
2. Këshilli i Etikës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë që zgjidhen nga Senati Akademik. Kryetari propozohet nga Rektorati.
3. Ky organ ka për qëllim:
   a) të shqyrtojë dhe t'i propozojë Rektorit parimet etike bazë të veprimtarisë së përgjithshme të Universitetit në funksion të mbrojtjes dhe të sigurimit të të drejtave themelore të njeriut;

b) të shqyrtojë dhe të japë mendim mbi trajtimin e rasteve të veçanta ose problematike që mund të lindin në veprimtarinë e Universitetit;
c) të sugjerojë zhvillimin e veprimtarive etike dhe kulturore në funksion të kultivimit dhe zhvillimit të vlerave etike dhe humane.

4. Funksionet e tjera të Këshillit të Etikës përcaktohen në Rregulloren e Këshillit të Etikës së Universitetit POLIS.

Neni 25
Komisionet e përhershme

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjiale, që lidhen me kualifikimin shkencor dhe promovimin akademik, garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikat e Universitetit POLIS.
2. Komisionet e përhershme krijohen në nivel institucional.
3. Anëtarët e komisioneve të përhershme të institucionit të arsimit të lartë propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Kur është e nevojshme në përbërje të komisioneve të përhershme merr pjesë edhe Këshilli i Studentëve përfaqësuar nga kryetari i tij pa të drejtë vote.
5. Komisionet e përhershme në Universitetin POLIS janë:
   a) Këshilli i Profesorëve;
   b) Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik;
   c) Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë;
   d) Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët.

Neni 26
Këshilli i Profesorëve

1. Në Universitetin POLIS, Këshilli i Profesorëve është organ kolegjial krijuar në nivel institucional në mbështetje të Nenit 25 të këtij statuti.
2. Këshilli i Profesorëve përbëhet nga i gjithë stafi akademik i Universitetit POLIS që kanë titullin akademik "Profesor".
3. Anëtarët e këtij këshilli propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati Akademik për një mandat dy vjecar, me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Këshilli i Profesorëve drejtohet nga Kryetari, i cili zgjidhet me votim nga anëtarët e tij. Procedura e emërimit të tij përcaktohet në rregulloren të Këshillit të Profesorëve.
5. Objekti i punës i Këshillit të Profesorëve është organizimi dhe drejtimi i studimeve të ciklit të tretë (doktoratë) dhe kualifikimit shkencor e pedagogjik pas saj.
6. Funksione të tjera të këshillit janë të përcaktuara në rregulloren e Këshillit të Profesorëve.

ORGANIZIMI ADMINISTRATIV

Neni 27
Organet dhe Autoritet Drejtuese Administrative

1. Organet dhe Autoritetet drejtuese administrative në Universitetin POLIS janë:
   a. Asambleja e Ortakëve;
   b. Administratori i Shoqërisë;
   c. Bordi i Administrimit;

d. Administratori i IAL-së;
e. Admistratorët e Njësive Kryesore;

2. Kriteret për autoritetet drejtuese, detyrat dhe të drejtat e këtyre autoriteteve, që burojnë nga ligji, përcaktohen në këtë statut dhe rregulloret e Universitetit POLIS

Neni 28
Asambleja e Ortakëve

1. Universiteti POLIS është themeluar nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "Universiteti POLIS" sh.p.k. Asambleja e Ortakëve është organ epror kolegjial, vendimmarrës i këtij personi juridik dhe ruan të drejtën e vendim-marrjes për aspektet më të rëndësishme të qëndrueshmërisë dhe zhvillimit institucional dhe financiar të Universitetit, brenda kufijve të të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në këtë Statut dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit POLIS.
2. Asambleja e Ortakëve ka përgjegjësinë dhe autoritetin për të garantuar funksionimin dhe vazhdimësinë e të gjithë veprimtarisë së Universitetit POLIS.
3. Asambleja e Ortakëve emëron Rektorin i cili konfirmohet nga Senati Akademik.
4. Asambleja e Ortakëve emëron dhe shkarkon Administratorin e IAL sipas parashikimeve në këtë statut dhe aktet e tjera të brendshme të Universiteti POLIS;
5. Miraton Statutin pas propozimit nga Senati Akademik dhe miratimit paraprak nga Bordi i Administrimit.
6. Miraton Planin Strategjik të Zhvillimit pas propozimit nga Senati Akademik dhe miratimit paraprak nga Bordi i Administrimit.
7. Miraton projekt buxhetin 3 dhe 1 vjeçar pas propozimit nga Senati Akademik dhe miratimit paraprak nga Bordi i Administrimit.
8. Përfaqësohet në Bordin e Administrimit ku inkurajon vendim-marrjen kolegjiale por ruan të drejtën e shumicës së votave sipas parashikimeve në ligjin 80/15 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".
9. Të drejtat e Asamblesë së Ortakëve mund të ushtrohen edhe nga Administratori i shoqërisë, i zgjedhur nga ortakët e shoqërisë, sipas përcaktimeve dhe kufijve të parashikuara nga ligjet në fuqi.
10. Pëmbush dhe plotëson të drejta dhe detyra të tjera të parashikuara në Statutin e Shoqërisë "Universiteti POLIS" sh.p.k..
11. Detaje mbi organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Ortakëve jepen në Statutin "Për veprimtarinë e Shoqërisë Universiteti POLIS SH.P.K..

Neni 29
Administratori i Shoqërisë Universiteti POLIS sh.p.k.

1. Administratori i Shoqërisë është përfaqësues ligjor i Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti POLIS.
2. Administratori i Shoqërisë në bashkëpunim me Administratorin e IAL mbikqyr dhe kontrollon veprimtarinë e Universitetit që lidhet me menaxhimin ekonomik, financiar dhe administrativ të tij.
3. Administratori zgjidhet nga Asambleja e Ortakëve.
4. Emërimi dhe përgjegjësitë e tij përcaktohen në Statutin "Për veprimtarinë e Shoqërisë Universiteti POLIS SH.P.K.".
5. Administratori i shpk-së ushtron këto funksione kryesore:
   a. Miraton kriteret për ndarjen e burimeve finaciare;

b. Shqyrton dhe analizon raportin financiar, hartuar nga Administratori i IAL dhe ia kalon për miratim Asamblesë së Ortakëve;
c. Vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve dhe zbatimin e buxhetit dhe i bën me dije Asamblesë së Ortakëve rezulatetet e vlerësimit;

Neni 30
Bordi i Administrimit

1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë sa i përket mbarëvajtjes financiare dhe administrative të tij.
2. Bordi i Administrimit në Universitetin POLIS ka në përbërjen e tij 5 (pesë) antarë prej të cilëve 4 përfaqësues të Asamblesë së Ortakëve dhe 1 (një) antar të Senatit Akademik.
3. Bordi i Administrimit drejtohet nga Kryetari i cili është Administratori i Shoqërisë Universiteti POLIS sh.p.k
4. Bordi i Administrimit mblidhet jo më pak se 2 (dy) herë në vit.
5. Mbledhjet e Bordit të Administrimit quhen të rregullta kur në to janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve; vendimet merren me shumicë të thjeshtë (mbi 50%) të anëtarëve pjesëmarrës.
6. Në mbledhjet e tij mund të ftojë edhe persona të jashtëm për mendim.
7. Bordi i Administrimit kryen këto funksione:
   a. Miraton strategjinë e zhvillimit të Universitetit pas propozimit nga Senati Akademik dhe ia përcjell për aprovim Asamblesë së Ortakëvë.
   b. Miraton statutin e Universitetit dhe ia përcjell për aprovim Senatit Akademik dhe Asamblesë së Ortakëvë.
   c. Miraton projektbuxhetin 3 dhe 1 vjeçar të insitucionit pas propozimit nga Senati Akademik dhe ia përcjell për aprovim Asamblesë së Ortakëvë.
   d. Miraton raportin financiar vjetor të propozuar nga Administratori i IAL.
   e. Vendos për hapjen dhe mbylljen e njësive kryesore dhe organeve të tjera të përfshira në strukturën e POLIS si dhe të programeve të reja të studimit në të tre ciklet e studimit, pasi merr miratimin nga Senati Akademik.
   f. miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
   g. jep mendim për projektrregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
   h. është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e Universitetit POLIS;
   i. miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga Rektorati
   j. Miraton kuotat e pranimit të studentëve të paracaktuara nga Përgjegjësit e Departamenteve i Universitetit POLIS.
   k. Përcakton strukturën e pagave sipas propozimeve të Rektoratit.
   l. Përcakton strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të Universitetit në të gjitha nivelet sipas propozimeve të Senatit Akademik.
8. Rektori dhe Administratori kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit të Administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, ose kur thirren nga Bordi.

Neni 31

1. Administratori i IAL-së është autoriteti më i lartë administrativ për përmbushjen e strategjisë së zhvillimit, administrimit të përgjithshëm dhe mirëfunksionimit financiar.
2. Administratori i IAL-së është specialist me formim të lartë dhe me përvojë menaxhuese. Administratori emërohet nga Asambleja e Ortakëve.
3. Administratori i IAL-së nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.

4. Administratori i IAL-së i raporton dhe ndërvepron për veprimtarinë e tij Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, sipas përcaktimeve të këtij statuti.
5. Administratori i IAL-së përveç përgjegjësive që mban si drejtues, ushtron edhe këto funksione:
   a. zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit, Senatit Akademik dhe të Asamblesë së Ortakëve me karakter financiar dhe administrativ;
   b. bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të Universitetit POLIS për çështje të administrimit të përditshëm;
   c. plotëson kërkesat e Rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike dhe administrative;
   d. organizon dhe kontrollon punën për hartimin e projekt buxhetit të Universitetit POLIS dhe zbatimit të tij.
   e. bashkërendon me Rektorin/Administratorin e shoqërisë procedurat për lidhjen dhe zgjidhjen e kontratave të punës me gjithë stafin.
   f. harton raportin vjetor financiar të Universitetit POLIS.
   g. ndjek komunikimin me institucionet përkatëse dhe palët e treta për çështje administrative dhe financiare.
   h. i propozon Senatit Akademik për miratim rregulloren për administrimin, sipas përcaktimeve të bëra nga Asambleja e Ortakëve.
   i. bashkë me Kryetarin e Bordit të Adminsitrimit bashkënënshkruan kontratat e studentëve dhe stafit administrativ
6. Funksionet e tjera të Administratorit të IAL-së përcaktohen në rregulloret e Universitetit POLIS.

KREU IV

PROGRAMET E STUDIMEVE

Neni 32
Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit në Universitetin POLIS

1. Hapja e një programi të ri studimi në Universitetin POLIS bëhet me miratimin e Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe buxhetin afatmesën dhe miratimin e ministrit përgjegjës për arsimin sipas përcaktimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 33
Forma e studimeve në Universitetin POLIS

1. Format e studimeve në Universitetin POLIS janë:
   a) studime me kohë të plotë;
   b) studime me kohë të zgjatur.

2. Format e studimit përcaktohet në aktin e hapjes së programit të studimit nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe zbatohet në përputhje me parashimet e ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodin e Punës.

Neni 34
Programet e studimeve universitare

1. Programet e studimeve në Universitetin POLIS organizohen në katër cikle të njëpasnjëshme: diploma profesionale, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Universiteti POLIS ofron programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS).
3. Programet e studimeve hartohen nga njësitë bazë të Universitetit POLIS dhe miratohen në Senatin Akademik sipas përcaktimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi.
4. Universiteti POLIS shpall publikisht programet e akredituara të studimeve që ofron para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve.

PROGRAMET E STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Neni 35
Diploma Profesionale

1. Programi Profesional synon pajisjen me njohuritë praktike bazë, mbi çështje dhe fenomene që lidhen me fushat e interesit.
2. Universiteti POLIS ofron program studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, me 120 (njëqind e njëzet) kredite, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, kohëzgjatja e të cilit përcaktohet në aktin e hapjes.
3. Në përfundim të programit profesional të studimit lëshohet "Diplomë profesionale" në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë statut dhe në rregulloret përkatëse të Unversitetit POLIS.
4. Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas kritereve të përcaktuara në këtë statut dhe në rregulloret përkatëse të Unversitetit POLIS.

Neni 36
Pranimi në Shkollë Profesionale

1. Pranimi i studentit në shkollë profesionale në Universitetin POLIS bëhet në përputhje me përcaktimet përkatëse të ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve nënligjore në fuqi.
2. Universiteti POLIS mund të përcaktojë kritere të veçanta për përzgjedhjet e kandidatëve për t'u pranuar në shkollën profesionale. Këto kritere i dërgohen

Qendrës së Shërbimeve Arsimore, pasi përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.
3. Kriteret e pranimit të studentëve bëhen publike.
4. Shpallja e studentëve fitues në programet e ciklit të parë bëhet me vendim të drejtuesit të njësisë bazë përgjegjëse për organizimin e programit.
5. Universiteti POLIS në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimeve Arsimore regjistron dhe matrikulon studentët në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

STUDIMET NË CIKLIN E PARË

Neni 37
Programet e ciklit të parë të studimeve

1. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta në fushat e interesit.
2. Programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 (njëqind e tetëdhjetë) kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tre) vite akademike;
3. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë statut dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 38
Pranimi në ciklin e parë të studimeve

1. Pranimi i studentit në ciklin e parë të studimeve në Universitetin POLIS bëhet në përputhje me përcaktimet përkatëse të ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve nënligjore në fuqi.
2. Universiteti POLIS mund të përcaktojë kritere të veçanta për përzgjedhjet e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Këto kritere i dërgohen Qendrës së Shërbimeve Arsimore, pasi përcaktohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.
3. Kriteret e pranimit të studentëve bëhen publike.
4. Shpallja e studentëve fitues në programet e ciklit të parë bëhet me vendim të drejtuesit të njësisë bazë përgjegjëse pë organizimin e programit.
5. Universiteti POLIS në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimeve Arsimore regjistron dhe matrikulon studentët në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

STUDIMET NË CIKLIN E DYTË

Neni 39
Programet e ciklit të dytë të studimeve

1. Programet e studimeve të ciklit të dytë japin njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur në një fushë brenda një specialiteti.
2. Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit:
   a) "Master i shkencave"; dhe
   b) "Master profesional",
   referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

3. Programet e studimit "Master i shkencave" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në:
   a) programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike;
   b) programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 kredite dhe me kohëzgjatje normale pesë vite akademike.
4. Programet e studimeve "Master profesional" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara, profesionale në një fushë të caktuar. Në U_POLIS këto programe organizohen me 90 kredite në zbatim të nenit 80, pika 4 të Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ku parashikohet se: "...e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore". Studimet e ciklit të dytë "Master profesional" përmbyllen me provim përfundimtar formimi ose punim diplome.
5. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare "Master i Shkencave" ose "Master profesional" në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë statut dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 40
Pranimi në ciklin e dytë të studimeve

1. Pranimi i studentit në ciklin e dytë të studimeve me 120 ECTS në Universitetin POLIS bëhet në përputhje me përcaktimet përkatëse të ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve nënligjore në fuqi.
2. Kriteret e pranimit të studentëve bëhen publike.
3. Universiteti POLIS në fillim të vitit akademik dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listen e studentëve të regjistruar.

Neni 41
Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë

1. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë synojnë pajisjen me njohuritë bazë dhe te avancuara, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta në fushat e interesit
2. Këto programe studimi realizohen me 300 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 5 vjet.
3. Në përfundim të programeve të integruara të studimeve lëshohet diplomë universitare "Master i Shkencave" në fushën e arsimimit të kryer.

Neni 42
Pranimi në programin e integruar të studimeve

1. Pranimi i studentit në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve në Universitetin POLIS bëhet në përputhje me përcaktimet përkatëse të ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve nënligjore në fuqi.
2. Universiteti POLIS mund të përcaktojë kritere të veçanta për përzgjedhjet e kandidatëve për t'u pranuar në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve. Këto kritere i dërgohen Qendrës së Shërbimeve Arsimore, pasi përcaktohen nga njësia kryesore dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.

3. Kriteret e pranimit të studentëve bëhen publike.
4. Shpallja e studentëve fitues në programet e ciklit të dytë bëhet me vendim të drejtuesit të njësisë kryesore përgjegjëse për organizimin e programit.
5. Universiteti POLIS në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimeve Arsimore regjistron dhe matrikulon studentët në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 43
Programi i studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional"

1. Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" në Universitetin POLIS janë programe të përbashkëta me institucione partnere të huaja sipas përcaktimit në nenin 80 të Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.
2. Këto programe studimi realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vjet.
3. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" lëshohet diplomë universitare "Master Profesional" në fushën e arsimimit të kryer.
4. Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve Master Profesional mund të transferohen në studimet e ciklit të dytë "Master i Shkencave" ose programet e integruara të ciklit të dytë, sipas kritereve të përcaktuara në këtë statut dhe në rregulloret përkatëse të Unversitetit POLIS.

Neni 44
Pranimi në ciklin e dytë të studimeve "Master Profesional"

1. Pranimi i studentit në programet e ciklit të dytë Master Profesional në Universitetin POLIS bëhet në përputhje me përcaktimet përkatëse të ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve nënligjore në fuqi.
2. Kriteret e pranimit të studentëve bëhen publike.
3. Universiteti POLIS në fillim të vitit akademik dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listen e studentëve të regjistruar.

STUDIMET NË CIKLIN E TRETË

Neni 45
Programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimit të doktoratës, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese;
2. Studimet e doktoratës pranë Universitetit POLIS zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike.
3. Programi i Doktoratës në Universitetin POLIS është program i përbashkët ndërkombëtar i ofruar nga një konsorcium në përbërjen e të cilit janë dy partnerët themelues: Universiteti POLIS dhe Universiteti i Ferrarës, Itali, si dhe tre partnerë të tjerë të asocuar.

4. Programi i studimit të doktoratës lëshohet me 180 kredite në zbatim të rregullores së programit të studimit dhe marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet institucioneve ofruese.
5. Pranimet në programin e doktoraturës bëhen sipas rregullores së programit të studimit i cili parashikon që procesi i pranimit të kryhet nga një komision i përbashkët i drejtuar nga Universiteti i Ferrarës.
6. Studentët fitues shpallen publikisht nga të dy institucionet dhe matrikulimi i tyre bëhet po nga të dy institucionet, ndërkohë që tarifa e studimit dhe detyrimet fiskale kryhen vetëm në një nga Universitetetet e përzgjedhur nga studenti gjatë aplikimit si institucioni bazë (home institution), pranë të cilit do të kryejë dhe aktivitetin e tij kërkimor.

7. Në përfundim të programeve të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e dyfishtë për gradën shkencore "Doktor". Aktualisht kjo gradë lëshohet vetëm nga dy institucionet themeluese të konsortiumit, por partnerët e asociuar mund të bëhen partnerë më të drejta të plota në konsortium, dhe në këtë rast lëshohet diplomë e shumëfishtë.
8. Kjo inkurajohet nga dy universitetet themeluese me qëllim ngritjen e cilësisë së programit dhe pjesëmarrjen e tij në programe ndërkombëtare të shkencës.

PROGRAME TË TJERA

Neni 46
Programet e studimeve të përbashkëta

1. Programet e studimeve të përbashkëta realizohen nga Universitetin POLIS në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose private, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
2. Programet e studimeve të përbashkëta organizohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë/shumëfishtë.
3. Universiteti POLIS organizon disa programe studimi të përbashkëta me institucione të huaja partnere sipas parashikimeve të neneve 43 – 45 të këtij statuti.

Neni 47
Programet e studimeve të formimit të vazhduar

1. Në vijim të programeve të ndryshme të studimeve, Universiteti POLIS ofron programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për specializime afatshkurtra, plotësime, thellime dhe freskime të njohurive.
2. Programet e studimeve të formimit të vazhduar ndihmojnë individët në rritjen e kualifikimit të tyre dhe të aftësive profesionale.
3. Në kuadër të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, Universiteti POLIS organizon edhe forma të tjera të ndryshme si kurse, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme.
4. Struktura e programeve, sipas pikës 3 të këtij neni, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre përcaktohen nga Universiteti POLIS në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Statut për programet e studimit.
5. Në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, Universiteti POLIS lëshon çertifikatat përkatëse.

TRANSFERIMET, NJOHJA DHE NJËHSIMI I KREDITEVE DHE PERIUDHAVE TË STUDIMIT

Neni 48
Transferimi i studimeve

1. Universiteti POLIS ofron mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.

2. Transferimet në Universitetin POLIS lejohen brenda fushave të studimit të njëjta ose të përafërta në periudhat e përcaktuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me rregulloret e Universitetit POLIS.
3. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet i takon Komisionit të Ekuivalentimit të Krediteve të ngritur nga njësia bazë e Universitetit POLIS, në përputhje procedurën e parashikuar në rregulloren përkatëse të Universitetit POLIS.

Neni 49
Njohja dhe njëhsimi i periudhave të studimit

1. Universiteti POLIS në sajë të bashkëpunimit me shumë partnerë ndërkombëtarë, si dhe të pjesëmarrjes së tij në projekte ndërkombëtare, i jep mundësi stafit dhe studentëve të marrin pjesë në programe mobiliteti dhe shkëmbimi duke kryer një periudhë studimi pranë institucionit partner.
2. Kohëzgjatja e periudhës së studimit dhe njohja e krediteve të fituara gjatë kësaj periudhe specifikohet në marrëveshjen e bashkëpunimit midis Universitetit POLIS dhe institucionit partner.
3. Detaje të tjera për njohjen e periudhave të studimit parashikohen në rregulloren përkatëse të Universitetit POLIS.

KREU VI

LËSHIMI I DIPLOMAVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA

Neni 50
Lëshimi i diplomave, çertifikatave dhe suplementi i diplomës

1. Universiteti POLIS në përfundim të programit të studimit, pajis studentët me diplomën ose çertifikatën përkatëse.
2. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të pare dhe të ciklit të dytë, shoqërohen me suplementin e diplomës.
3. Universiteti POLIS regjistron çdo formë diplome dhe çertifikate në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, përpara se ta lëshojë atë.
4. Universiteti POLIS në përputhje me legjislacionin në fuqi nuk mund të lëshojë dublikatë diplome, por dokument të barazvlefshëm me diplomën në formën e vërtetimit.

5. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen nga Universiteti POLIS në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
6. Nga momenti i diplomimit deri në marrjen e kartonit të diplomës Universiteti POLIS lëshon vetëm një herë, një kopje vërtetim diplomimi i cili vërteton përfundimin me sukses të programit të studimit.
7. Emërtimet e të gjithë diplomave të lëshuara nga Universiteti POLIS gjenden në Shtojcën 2 të këtij Statuti, që është pjesë integrale dhe e pandarë e tij.

KREU VII

ORGANIZIMI I STUDIMEVE UNIVERSITARE

Neni 51
Format e Mësimit

1. Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimit dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma harmonizohen midis tyre përmes raporteve të caktuara, të parashikuara në planet mësimore, programet e lëndëve, dhe rregulloren didaktike. Në Universitetin POLIS format kryesore të punës mësimore janë:
   a. Format e mësimit teorik e praktik: leksionet, seminaret, ushtrimet, punët laboratorike dhe studio, konsultimet, prezantimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, esetë, etj.
   b. Format e kontrollit të dijeve: provimet e kursit, mbrojtjet e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave e projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provimet në formën e bashkëbisedimit të hapur, provimet e formimit, mbrojtje e temave të diplomave, etj.
2. Rregulla më të hollësishme parashikohen në Rregulloren Didaktike.

Neni 52
Sistemi i vlerësimit

1. Në Universitetin POLIS për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10 nota (nga 1 tek 10, ku 10 është vlerësimi maksimal). Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Notat nga pesë e lart janë kaluese.
2. Forma e vlerësimit, mënyra e organizimit të tij dhe pesha që zë çdo element në vlerësimin përfundimtar shprehen në programin mësimor dhe i bëhen të ditur studentit që në fillim të semestrit.

Neni 53
Gjuha e Studimeve

1. Gjuha zyrtare në të cilën do të zhvillohet procesi mësimor është gjuha shqipe. Në përputhje me strategjinë e ndërkombëtarizimit si dhe si pasojë e pranisë së lektorëve të huaj/mobilitetit etj, gjuha e dytë zyrtare është gjuha angleze.
2. Në raste të lektorëve të ftuar nga vende të tjera gjuha e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve mund të jetë gjuha angleze.
3. Gjuha në të cilën do të zhvillohet procesi mësimor për programet e përbashkëta të studimit është gjuha angleze.

UNIVERSITETI POLIS

KREU VIII

KËRKIMI SHKENCOR NË UNIVERSITETIN POLIS

Neni 54
Kërkimi Shkencor dhe Zhvillimi

1. Universiteti POLIS kryen kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim dhe inovacion dhe veprimtari të tjera krijuese në përputhje me misionin, vizionin dhe strategjinë e zhvillimit të tij.

2. Kërkimi shkencor në Universitetin POLIS zhvillohet sipas Planit Vjetor të Kërkimit dhe Zhvillimit hartuar nga njësitë kryesore dhe miratuar nga Senati Akademik, ku përcaktohen fushat kryesore kërkimit në përputhje me fushat prioritare të U_POLIS dhe zhvillimit kombëtar.
3. Veprimtaria e kërkimit dhe zhvillimit që kryhet në Universitetin POLIS synon dhe në rritjen e cilësisë së arsimimit. Ajo u jep studentëve aftësi metodologjike në kërkim, studim e projektim, jep mundësi të vazhdueshme në plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore e praktike të avancuara; përmirëson kualifikimet e personelit akademik; krijon mjete materiale për zhvillimin e Universitetit POLIS.
4. Kërkimi shkencor realizohet nëpërmjet:
   a. njësive kryesore ku njëra prej tyre e ka fokus kryesor;
   b. njësive bazë;
   c. qendrës ndërdisiplinore;
   d. bashkëpunimit me partnerë strategjikë: Institutin për Zhvillimin e Habitatit Co-PLAN, Studion e Arkitekturës dhe Projektimit Urban Metro_POLIS, Shoqata e Arkitektëve, Urbanistëve dhe Planifikuesve Urbanëve AUA, dhe Shoqatat europiane ku U_POLIS është antarësuar;
   e. pjesëmarrjes në studime e projekte kombëtare e ndërkombëtare;
   f. pjesëmarrjes së stafit të brendshëm akademik në studime të tjera me qëllim kualifikimin individual dhe/ose në funksion të nevojave konkrete të shoqërisë.
5. Personeli akademik mund të kryejë veprimtari kërkimi, zhvillimi dhe konsulencë për të tretë me kusht plotësimin e detyrimeve ndaj universitetit dhe me miratimin e drejtuesit.
6. Kërkimi shkencor ka si synim, ndër të tjera, në arritjen e rezultateve kërkimore në bazë të të cilave, të hartohen propozime inovacioni në fushat e interesit të Universitetit POLIS.

Neni 55
Vlerësimi i Kërkimit Shkencor

1. Koha e punës së personelit akademik dedikuar kërkimit shkencor përcaktohet në kontratën e punës dhe anekset e saj.
2. Veprimtaria kërkimore - shkencore është subjekt i vlerësimit sipas mekanizmave të garantimit të cilësisë të aplikuara nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë të Universitetit POLIS.
3. Rezultatet e procesit të vlerësimit të kërkimit shkencor i komunikohen personelit akademik dhe raportohen në Rektoratit e Universitetit POLIS.

KREU IX

Neni 56
Personeli i Universitetit POLIS

1. Personeli i Universiteti POLIS përbëhet nga:
   a. personeli akademik;
   b. personel ndihmës akademik;
   c. personeli administrativ.
2. Detyrat dhe të drejtat e personelit të Universitetit POLIS përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të institucionit si dhe në kontratat individuale të punës në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 57
Personeli Akademik

1. Personeli akademik në Universitetin POLIS kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit, këshillim për studentët si dhe veprimtari të tjera.
2. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor. Personeli akademik në U_POLIS, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
   a) profesorë;
   b) lektorë;
   c) asistent-lektorë
3. Në kategorinë "Profesorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë titujt akademikë "Profesorë" dhe "Profesor i asociuar".
4. Në kategorinë "Lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore "Doktor" ose "Docent", kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në rregulloret përkatëse të Universitetit POLIS.
5. Në kategorinë "Asistent-lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Asistent-lektorët duhet të kenë së paku diplomën "Master i shkencave" dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në rregulloret përkatëse të Universitetit POLIS.
6. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës ose minimalisht një kualifikim të dytë shtesë në nivel master.
7. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme të personelit akademik përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme dhe në kontratat e punës dhe anekset përkatëse.

Neni 58
Fitimi i titujve akademikë

1. Për fitimin e titullit "Profesor i asociuar" mund të aplikojë personeli akademik që gëzon gradën shkencore "Doktor", prej së paku pesë vitesh, është personel akademik i kategorisë "Lektor" dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit. Për fitimin e titullit "Profesor" mund të aplikojë personeli akademik që gëzon prej së paku pesë vjetësh titullin "Profesor i asociuar", si dhe përmbush standardet shtetërore për fitimin e titullit.
2. Personeli akademik i U_POLIS, që përmbush kriteret mund të aplikojë për marrjen e titujve akademikë "Profesor" ose "Profesor i asociuar" pranë U_POLIS ose IAL-ve të tjera që japin këto tituj.

3. Personelit akademik, që mban titullin "Profesor", pas daljes në pension, në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, me propozim të njësisë bazë ku ka zhvilluar karrierën e tij dhe me vendim të Senatit Akademik, i akordohet titulli "Profesor emeritus", sipas kritereve të përcaktuara në ligj.

Neni 59
Personeli akademik i ftuar

1. Njësitë bazë të Universitetit POLIS sipas kërkesave akademike kërkojnë të punësojnë me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiues, personalitete, artistë vendas ose të huaj.

2. Për përzgjedhjen e personelit akademik të ftuar ndërthuren kualifikimet e tyre akademike me nevojën e njësisë bazë për veprimtari mësimdhënieje ose kërkimore-shkencore.

Neni 60
Personeli akademik me kontratë

1. Universiteti POLIS punëson me kontratë personalitete vendase ose të huaja për periudha të shkurtra kohe.
2. Ky personel punësohet me vendim të Rektoratit në bazë të propozimeve të fakulteteve.
3. Për veprimtari të caktuara ku i rëndësishëm është kualifikimi dhe përvoja profesionale, kriteret për kualifikimin akademik mund të jenë të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 55 të këtij Statuti.
4. Kriteret e përzgjedhjes dhe rekrutimit për stafin e huaj në programet e përbashkëta bëhet nga IAL-të partnere.

Neni 61
Punësimi

1. Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga Bordi i Administrimit pas propozimit të Senatit Akademik. Kriteret e punësimit për çdo kategori të personelit akademik dhe administrativ përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit POLIS, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në Universitetin POLIS nuk mund të punësohet si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Ai mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjetër të arsimit të lartë, me miratimin e drejtuesit të njësisë bazë dhe të Rektorit, si dhe në marrëveshje mes institucioneve. Pjesëmarrja e personelit akademik në projekte, konsulenca, botime dhe shërbime që realizohen në Universitetin POLIS, ku ai është i punësuar me kohë të plotë, nuk konsiderohet si dypunësim brenda institucionit.
3. Të drejtat dhe detyrat e personelit të Universitetit POLIS, rregullohen nga legjislacioni në fuqi, përcaktohen në kodin e punës, rregulloret përkatëse të Universitetit POLIS dhe në kontratat individuale.

KREU X

Neni 62
Të drejtat dhe detyrat e studentëve

1. Një person e fiton statusin e studentit me regjistrimin në Universitetin POLIS dhe e humbet atë me marrjen e diplomës, me ndërprerjen e studimeve ose me përjashtimin nga shkolla.
2. Studenti ka të drejtë:
   a. të përfaqësohet në Senatin Akademik;
   b. të kërkojë respektimin e procesit mësimor dhe të procedurave siç parashikohen në këtë Statut dhe Rregulloren didaktike;
   c. të shprehë opinionet e veta për cilësinë e mësimdhenies dhe punën e personelit akademik;
   d. të ndjekë leksione, seminare/ushtrime dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore të organizuara në përputhje me statusin e tyre;
   e. të përdorë mjediset, pajisjet e shkollës si dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga institucioni;
   f. të organizohet në shoqata studentore jo-politike dhe jo-ekonomike duke ju përmbajtur përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse;
   g. të pajiset me kartën e studentit.
   h. të nënshkruajnë kontratë, në momentin e regjistrimit në Universitetin POLIS.
   i. të sigurohen nga institucioni i arsimit të lartë, në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera.
3. Studenti është i detyruar:
   a. të njohë dhe të zbatojë rregullat e hartuara nga Universiteti POLIS;
   b. të marrë pjesë në veprimtarinë akademike dhe të zbatojë rregulloret e Universitetit;
   c. të paguajë tarifat e shkollimit si dhe të gjitha detyrimet e tjera financiare të përcaktuara në rregulloren përkatëse;
   d. të respektojë rregullat e etikës;
   e. të zhdëmtojë dëmet materiale që mund t`i shkaktojë Universitetit;
   f. të respektojë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë.

Neni 63
Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët

1. Komisioni i Marrëdhënieve dhe Këshillimit me Studentët është organ kolegjial krijuar në nivel institucional në mbështetje të Nenit 25 të këtij statuti.
2. Anëtarët e këtij komisioni propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati Akademik për një mandat dy vjecar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët përbëhet nga 5 anëtarë. Raportet e përfaqësimit janë: 3 Zëvendës - Drejtuesit e njësive kryesore, 1 përfaqësues i stafit akademik dhe 1 përfaqësues i stafit administrativ.
4. Funksionet e ushtruara nga ky komision janë:
   a. Informimi i studentëve dhe sigurimi i transparencës së plotë për çështjet e aspektet akademike, mësimore dhe shkencore, si dhe me të drejtat e detyrat e tyre;
   b. Orientimi i studentëve gjatë shkollimit për zgjedhjen e fushave formuese specifike dhe mundësive të formimit që ofron universiteti;
   c. Orientimi dhe njohja e studentëve me tregun e punës në përgjithësi;

d. Garantimi i përfshirjes e studentëve ne vendim-marrje, proceset e aktivitetet kryesore që lidhen me mësimdhënien dhe aktivitetet e tjera kërkimore dhe zhvilluese;
e. Mbledhja në mënyrë të vazhduar e informacionit nga studentët e diplomuar dhe gjurmimi i punësimit të tyre dhe/ose avancimit në karrierë.

Neni 64
Këshilli i studentëve

1. Në Universitetin POLIS, studentët organizohen në Këshillin e Studentëve, i cili është organizim i pavarur, që nuk zhvillon aktivitete politike dhe ekonomike. Këshilli promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.

2. Këshilli i studentëve zgjidhen çdo 2 vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Në rastet kur një individ i zgjedhur në këshilli i studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati që ka qenë i renditur i dyti për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit deri në zhvillimin e zgjedhjeve të tjera.
3. Këshilli i Studentëve nuk ka të drejtë të organizohet në struktura të tjera (jo) politike brenda Universitetit POLIS. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tij përcaktohen në Rregulloren e Këshillit të Studentëve, e cila hartohen në përputhje me kërkesat e statutit dhe propozimeve të studentëve.
4. Këshilli i studentëve nëpërmjet përfaqësimit të tyre në organet vendim-marrëse shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të Universitetit POLIS, si për planet e programet e studimeve, rregulloret dhe veprimtaritë mësimore, cilësinë e shërbimeve, të drejtën për të studiuar, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive.
5. Universiteti POLIS mbështet këshillin e studentëve dhe financon veprimtarinë e tij në një masë të caktuar dhe në përputhje me mundësitë e financimit sipas parashikimeve në buxhetin vjetor.

Neni 65
Subvencionet për studentët

1. Për të nxitur e përkrahur studentët e shkëlqyer dhe studentët nga shtresa sociale në nevojë, Universiteti POLIS ndjek politika financiare lehtësuese, të cilat konsistojnë në subvencionimin e programeve të veçanta dhe reduktimin e tarifës së shkollimit për programe të caktuara.
2. Procedurat dhe kriteret që përdoren për këtë politikë lehtësuese financiare përcaktohen nga Bordi i Administrimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU XI

SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË NË UNIVERSITETIN POLIS

Neni 66
Komisioni i për Garantimin e Standarteve të Cilësisë

1. Komisioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë është organ kolegjial krijuar në nivel institucional në mbështetje të Nenit 25 të këtij statuti.
2. Anëtarët e këtij komisioni propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati Akademik për një mandat dy vjecar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Komisioni për Garantimin e Standarteve të Cilësisë dhe Monitorimit përbëhet nga 5 anëtarë. Raportet e përfaqësimit janë: Rektori, Administratori i IAL-së dhe 3 Drejtuesit e njësive kryesore.
4. Detyrat dhe funksionimi i këtij Komisioni përcaktohen në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë.

Neni 67
Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë

1. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është një njësi vlerësimi e përhershme, përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë. Njësia ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.

2. Anëtarët e Njësisë së Brendshme Sigurimit të Cilësisë emërohen nga Rektori.
3. Në përbërje të Njësisë janë përfaqësues nga stafi akademik, stafi administrativ, një ekspert i jashtëm dhe përfaqësues nga komuniteti studentor.
4. Koordinatori i kësaj njësie është një nga anëtarët e mësipërm që është anëtar i personelit të brendshëm akademik që nuk ushtron ndonjë funksion ekzekutiv në Universitetin POLIS.
5. Kjo Njësi ka për detyrë të bëjë vlerësimin e të gjithë elementëve të cilësisë sipas standardeve të ENQA-s, të vlerësojë periodikisht procesin mësimor si dhe efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore.
6. Detyrat dhe funksionimi i kësaj njësie përcaktohen në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë.

SIGURIMI I JASHTËM I CILËSISË NË UNIVERSITETIN POLIS

Neni 68
Akreditimi Kombëtar

1. Akreditimi institucional dhe i programeve të studimit realizohet nën përgjegjësinë e Njësisë së Brendshme e Sigurimit të Cilësisë.

2. Për të këtë proçes, ngrihet grupi i vlerësimit të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga organizimet studentore. Në rast nevoje, ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm. Grupi i vlerësimit të brendshëm ngrihet nga njësia përkatëse. Ai ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Vlerësimi i brendshëm realizohet në përputhje me udhëzimet përkatëse të ASCAL.
3. Akreditimi institucional dhe i programeve të studimit ka vlefshmëri sipas përcaktimit në vendimin e akreditimit.
4. Mënyra e organizimit të vlerësimit të brendshëm, aktivitetet që kryhen, përgjegjësitë dhe mënyra e paraqitjes së rezultateve përcaktohen në rregulloret dhe procedurat përkatëse.
5. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me ASCAL organizon trajnim të anëtarëve të grupit të vlerësimit. Për anëtarët e grupit të vlerësimit njësia merr masat e sigurimit të kushteve të përshtatshme për realizimin e kësaj detyre.
6. Universiteti siguron burimet e nevojshme financiare për mbulimin e të gjitha aktiviteteve të procesit të vlerësimit të brendshëm.
7. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë mban lidhje të vazhdueshme me ASCAL për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë.

8. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet gjatë proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit, në përputhje me afatet, procedurat dhe nga autoritetet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 69
Akreditimi Ndërkombëtar

1. Universiteti POLIS në në përputhje me nenin 80 të Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ofron programe të përbashkëta dhe diploma të dyfishta/shumëfishta në bashkëpunim me partnerë të tjerë ndërkombëtare.
2. Në proceset e vlerësimit të jashtëm të cilësisë merren në konsideratë dhe përmbushja e standarteve, vlerësimet, akreditimet ndërkombëtare në vendin e origjinës për programet e mësipërme.
3. Për programe të veçanta Universiteti POLIS mund të bashkëpunojë me shoqatat europiane ku është i antarësuar për vlerësim ndërkombëtar të këtyre programeve.

KREU XII

NORMA ORGANIZATIVE DHE RREGULLORE

Neni 70
Rregulloret e Universitetit POLIS

1. Organizimi dhe funksionimi i Universitetit POLIS përcaktohet në Statut dhe në rregulloret e mëposhtme:
   a. Rregullore e Përgjithshme.
   b. Rregullore Didaktike.
   c. Rregullore e Administrimit.
   d. Çdo rregullore tjetër në përputhje me ligjet në fuqi.

Neni 71
Rregullore e Përgjithshme

1. Rregullorja e Përgjithshme përmban rregulla për organizimin dhe funksionimin e Universitetit POLIS.
2. Senati Akademik, pasi merr mendimin e Rektorit, miraton Rregulloren e Përgjithshme me votën e shumicës së anëtarëve.

Neni 72
Rregullore Didaktike

1. Rregullorja Didaktike përcakton rregullat e zhvillimit të procesit mësimor në Universitetin POLIS.
2. Senati Akademik, pasi merr mendimin e Rektorit, miraton Rregulloren Didaktike me votën e shumicës së anëtarëve.

Neni 73
Rregullore e Administrimit

1. Rregullorja e Administrimit përmbanë dispozita të përgjithshme për organizimin e veprimtarisë së organeve drejtuese dhe administrative të Universitetit POLIS.
2. Senati Akademik, me propozim të Administratorit, miraton Rregulloren e Administrimit me votën e shumicës së anëtarëve.

Neni 74
Raportimi

1. Universiteti POLIS paraqet, për çdo vit akademik, pranë ministrisë përgjegjëse: raportet vjetore për veprimtarinë e kryer.
2. Raporti vjetor i paraqitet ministrisë përgjegjëse për arsimin pas miratimit nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.

Neni 75
Marrëdhëniet me jashtë

1. Universiteti POLIS ka të drejtën e vendosjes së marrëdhënieve me Institucione të Arsimit të Lartë Shqiptare apo të huaja, si edhe me institucione kërkimore shkencore Shqiptare apo të huaja me qëllim bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojës akademike, shkencore etj.
2. Universiteti POLIS ka të drejtën e anëtarësimit në shoqata e organizata kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë. Ai bashkëvepron me organizma jo-qeveritare Shqiptare apo të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë.

KREU XIII
NORMA ADMINISTRATIVE DHE FINANCIARE

Neni 76
Parimet e administrimit

1. Aktiviteti administrativ ndihmon në detyrat didaktike dhe të kërkimit shkencor të Universitetit POLIS dhe ka si synim lehtësimin e punës për arritjen e objektivave të vendosur.
2. Aktiviteti administrativ përcaktohet në Rregulloren e Administrimit të Universitetit POLIS në përputhje me parimet e përgjithshme të parashikuara në statutin e IAL-së dhe sh.p.k-së dhe legjisacionin në fuqi.

Neni 77
Financimi dhe Veprimtaria ekonomike

1. Universiteti POLIS është person juridik privat sh.p.k, që financohet nga të ardhurat e tarifave të shkollimit të vendosura përpara fillimit të regjistrimit të çdo viti akademik si edhe nga aktiviteti praktik që zhvillon ky universitet në fushën e konsulencës profesionale që përputhet me fushën ku zhvillon edhe aktivitetin akademik, nga donacionet, nga kontributi i themeluesve dhe burime të tjera.

2. Universiteti POLIS ka të drejtë të krijojë llogarinë e përdorë të ardhurat që realizon gjatë veprimtarisë së tij në përputhje me rregullat e buxhetit të detajuara në Rregulloren e Administrimit të Universitetit POLIS dhe në përputhje me ligjin për shoqëritë tregëtare.
3. Po ashtu, gjithçka tjetër lidhur me veçoritë e zbatimit të rregullave të kontabilitetit e të administrimit të vlerave materiale e monetare, kontrollit dhe auditimit ekonomiko-financiar në Universitetin POLIS përcaktohen me Rregulloren e Administrimit të Universitetit POLIS duke ju përmbajtur legjislacionit përkatës.

KREU XIV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 78
Emri, vula zyrtare dhe stema

1. Universiteti POLIS ka emrin, vulën zyrtare dhe stemën (logon) ndryshimet e të cilave miratohen me vendim të Senatit Akademik dhe për sa më sipër vihet në dijeni ministria përgjegjëse për arsimin.

Neni 79
Miratimi dhe rishikimi i Statutit

1. Statuti i Universitetit Polis përmban normat bazë, që rregullojnë veprimtarinë e tij.
2. Statuti i IAL Universiteti POLIS hartohet dhe ndryshohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ai miratohet nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit dhe Asambleja e Ortakëve. Statuti i dërgohet ministrit përgjegjës për arsimin, i cili, brenda 2 (dy) muajve, kryen kontrollin e ligjshmërisë së tij. Kur ministri nuk ka vërejtje për ligjshmërinë e statutit ose nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, statuti konsiderohet i miratuar. Ndryshimet në statut miratohen me të njëjtat procedura
3. Statuti miratohet nga Senati Akademik i Universitetit POLIS me shumicën e votave të anëtarëve të tij.
4. Statuti i Universitetit POLIS mund të ndryshohet, sipas procedurave dhe me shumicën e kërkuar në këtë Statut.
5. Ky Statut është miratuar me Vendim të Senatit Akademik të Universitetit POLIS, Nr. 13, datë 13.06.2016.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij statuti shfuqizohet çdo akt tjetër me fuqi të njëjtë në Universitetin POLIS si dhe çdo dispozitë e rregulloreve apo akteve të tjera, që janë në kundërshtim me këtë Statut.

UNIVERSITETI POLIS

SHTOJCA 1

STRUKTURA ORGANIZATIVE E UNIVERSITETI POLIS

I. FAKULTETI ARKITEKTURË DHE DIZAJN (FAD):

1. Departamenti Art dhe Dizajn;
2. Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri;
3. Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn;

II. FAKULTETI PLANIFIKIM, MJEDIS DHE MENAXHIM URBAN (FPMMU):

1. Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban;
2. Departamenti i Mjedisit;
3. Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë;

III. FAKULTETI PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM (FKZH):

1. Departamenti i Kërkimit Shkencor;
2. Departamenti i Kërkimit të Aplikuar;
3. Qendra e Burimeve dhe Informacionit;

IV. QENDRA STUDIMORE NDËRDISIPLINORE KËRKIMORE E INOVACIONIT

(QSNKI):

Koordinon aktivitetin e njësive bazë të treta pranë çdo njësie kryesore (qendrave)

SHTOJCA 2

PROGRAMET E STUDIMIT PRANË UNIVERSITETIT POLIS:

1. Programet e studimit me karakter profesional "DIPLOMË PROFESIONALE" në:

"EFIÇENCË ENERGJITIKE";

2. Programet e studimit të ciklit të parë "BACHELOR" në:

"ART DHE DIZAJN";
"INXHINIERI NDËRTIMI";
"STUDIME MJEDISORE";

3. Programet e integruara të studimit të ciklit të dytë "MASTER I SHKENCAVE" në:

"ARKITEKTURË DHE DIZAJN URBAN";
"PLANIFIKIM DHE MENAXHIM URBAN";

4. Programet e studimit të ciklit të dytë "MASTER I SHKENCAVE" në:

"DIZAJN TË APLIKUAR";
"INXHINIERI NDËRTIMI" me profile: "STRUKTURË" dhe "GJEOTEKNIKË";
"MENAXHIM MJEDISOR URBAN";

5. Programet e studimit të ciklit të dytë "MASTER PROFESIONAL" në:

"POLITIKAT E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT" me profile:

- "PLANIFIKIM HAPËSINOR DHE APLIKIME GIS",
- "STREHIM DHE ZHVILLIM TOKE"

- "ZHVILLIM SOCIAL URBAN DHE [illegible]JERËZORE".

"DIZAJN PARAMETRIK" me profile:

- "DIZAJN ARKITEKTONIK DHE PARAMETRIK",
- "DIZAJN ESTETIK STRUKTUROR"
- "DIZAJN URBAN DHE PEIZAZHI".

"ADMINISTRIM BIZNESI" me profile:

- "SIPËRMARRJE DHE INOVACION",
- "PASURITË E PALUAJTSHME"
- "MARKETING DHE STRATEGJI"

6. Programet e studimit të ciklit të tretë 'DOKTORATË" në:

"ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM URBAN"

APPROVAL OF A CHANGE IN THE STATUTE OF THE POLIS UNIVERSITY

Based of Article 102 of the Constitution, Article 33 of Law No. 80/2015 "*For the higher education of the Republic of Albania*",

ORDER:

1. The approval of an amendment to the statute of the Polis University approved by Order No. 281, dated 19.05.2017 of Minister of Education, proposed according to the Decision of the Academic Senate No. 15, dated 26.09.2022 and Administrative Board Decision No. 8, dated 30.09.2022, of the repeal of Appendix 2 attached and a constituent part of the statute.
2. Changes in the statute of the Polis University are approved according to the provisions of the legal framework in force and this statute.
3. The changes come into force immediately after the entry into force of this order.
4. The relevant institutions are charged with the implementation of this order

Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5 Kashar, Tiranë, Shqipëri, Tel: +355 (4) 2407420 / 2407421, Fax: +355 (4) 2407422, Cel: +355 (0) 694088111
www.universitetipolis.edu.al; info@universitetipolis.edu.al
NUIS K62308008S

U-Polis
Nr. 1041/22 Prot
Datë: 01.12.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KUADRIT RREGULLATOR

Nr. 5847/4 prot. Tiranë, më 30.11.2022

Lënda: Dërgohet urdhër për njohje dhe zbatim

UNIVERSITETIT "POLIS"
Adresa: Rruga "Bylis 12", Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar, SH2, Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 709, datë 30.11.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit *"Për miratimin e një ndryshimi në statutin e Universitetit "Polis"*.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen TOLA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT - TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5847/3 Prot. Tiranë, më 30.11.2022

URDHËR

Nr. 708, datë 30.11.2022

PËR
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË STATUTIN E UNIVERSITETIT "POLIS"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e një ndryshimi në Statutin e Universitetit "Polis", të miratuar me urdhrin nr. 281, datë 19.05.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, *"Për miratimin e statutit të Universitetit "Polis"*, propozuar sipas vendimit nr. 15, datë 26.09.2022 të Senatit Akademik dhe vendimit nr. 8 datë 30.09.2022 të Bordit të Administrimit, për shfuqizimin e shtojcës 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e statutit.

2. Ndryshimi në statutin e Universitetit "Polis", miratohet sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe këtij statuti.

3. Ndryshimi i statutit të Universitetit "Polis", hyn në fuqi pas hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Universiteti "Polis".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TIRANË

SHTOJCA 2

SHPËRNDARJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT SIPAS NJËSIVE BAZË

I. FAKULTETI ARKITEKTURË DHE DIZAJN (FAD):

1. Departamenti Art dhe Dizajn:

- "Bachelor" në "Art Dhe Dizajn" – përfundon me punim diplome;
- "Master i Shkencave" në "Dizajn Të Aplikuar" – përfundon me temë diplome.

2. Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri:

- "Bachelor" në "Inxhinieri Ndërtimi" – përfundon me provim diplome;
- "Master i Shkencave" në "Inxhinieri Ndërtimi" me profile:
  - "Strukturë";
  - "Gjeoteknikë"

  - përfundon me temë diplome;
- Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Arkitekturë dhe Dizajn Urban" - përfundon me temë diplome;
- "Master Profesional" në "Arkitekturë Dixhitale"
  - përfundon me provim diplome.

3. Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn.

II. FAKULTETI PLANIFIKIM, MJEDIS DHE MENAXHIM URBAN (FPMMU):

1. Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban:

- Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Planifikimdhe Menaxhim Urban" - përfundon me temë diplome;
- "Master i Shkencave" në "Administrim Biznesi"
  - përfundon me provim diploma;
- "Master Profesional" në "Planifikim Territori dhe GIS";
  - përfundon me provim diplome;
- "Bachelor" në "Administrim Biznes"
  – përfundon me punim diplome;

2. Departamenti i Mjedisit;

- "Bachelor" në "Studime Mjedisore" - përfundon me provim diplome.
- "Master i Shkencave" në "Menaxhim Mjedisor Urban" - përfundon me temë diplome.

3. Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë;

UNIVERSITETI POLIS

III. FAKULTETI PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM (FKZH):

1. Departamenti i Kërkimit Shkencor;

- "Doktoratë" në:"Arkitekturë dhe Planifikim Urban" - përfundon me dizertacion;
- "Bachelor" në "Shkenca Kompjuterike" – përfundon me temë diplome;
- "Master i Shkencave" në "Shkenca Kompjuterike";
- "Diplomë Profesionale" në "Mirëmbajtje e rrjeteve elektrike" - përfundon me provim diploma.

2. Departamenti i Kërkimit të Aplikuar;

- "Diplomë Profesionale" Në "Efiçencë Energjitike" - përfundon me provim diploma.

3. Qendra e Burimeve dhe Informacionit;

IV. QENDRA STUDIMORE NDËRDISIPLINORE KËRKIMORE E INOVACIONIT (QSNKI):

Koordinon aktivitetin e njësive bazë të treta pranë çdo njësie kryesore (qendrave)

Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit Urban - UNIVERSITETI POLIS

Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5 Kashar, Tiranë, Shqipëri, Tel: +355 (4) 2407420 / 2407421, Fax: +355 (4) 2407422, Cel: +355 (0) 694088111
www.universitetipolis.edu.al; info@universitetipolis.edu.al